



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina




DREJTORIA E ARSIMIT  
Nr. 03-111/01-119783/23;  
Data: 14.07.2023

Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), nenit 5, pikës c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, Nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Nenit 10 paragrafi 3.6 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 11/2023 për Kurrikulën me zgjedhje në arsimin parauniversitar, Drejtoria e Arsimit shpallë:

**KONKURS PUBLIK  
PËR ANGAZHIM TË PËRKOSSHËM TË MËSIMDHËNËSVE NË REALIZIMIN  
E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE**

Nr.	Pozita (afat të caktuar)	Projekti i përgatitur për lëndën zgjedhore	IEA	Klasa	Orët	Totali
1	Një (1) Mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe	1. Argumentimi logjik dhe të folurit në publik (17 orë mësimore) 2. Orientim në Karrierë (4orë mësimore)	1. SHFMU Dardania	VI, VII, VIII, IX	21	21
2.	Një (1) Mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe	1. Argumentim logjik dhe mendim kritik (12 Orë mësimore) 2. Orientim në karrierë (4 orë mësimore); 3. Orientim në karrierë (3 orë mësimore);	1. SHML "S.Frashëri" 1. SHFMU "F.Konica" 2. SHFMU "Iliria"	XI, IX IX	12 4 3	19
3.	Një (1) Mësimdhënës/e për Sociologji, Edukatë Qytetare, Kimi	1. Parandalimi i dukurive negative dhe lëndëve narkotike (8 orë mësimore) 2. Parandalimi i dukurive negative dhe lëndëve narkotike (6 orë mësimore) 3. Parandalimi i dukurive negative dhe lëndëve narkotike (4 orë mësimore)	1. SHFMU "N.Frashëri" 2. SHFMU "F.Konica" 3. SHFMU A.Z Çajupi	VI IX VI, VIII, IX	8 6 4	18
4.	Një (1) Mësimdhënës/e për Sociologji, Psikologji	1. Zgjidhja e konflikteve në shkollë (5 orë mësimore) 2. Shëndeti mendor (9 orë mësimore)	1. SHFMU "E.Gjika" 2. SHFMU "F.Konica"	VII, VIII; VII, VIII.	5 9	14
5	Një (1) Mësimdhënës/e për Histori dhe Edukatë Qytetare	1. Trashëgimi kulturore dhe diversiteti kulturor (12 orë mësimore)	1. SHFMU "Xh.Mustafa	VII,IX	12	12
6.	Një (1) Mësimdhënës/e për Histori dhe Edukatë Qytetare	1.Trashëgimi kulturore dhe diversiteti kulturor (18 orë mësimore);	2.SHFMU "I.Qemali"	IX	18	18





1. Kriteret e kualifikimit për projekt propozimin “Argumentim logjik dhe të folurit në publik”; Orientim në Karrierë”; kandidatët të jenë të kualifikuar si mësimdhënës/e të lëndës: Gjuhë shqipe, si vijon:

- Niveli master (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

2. Kriteret e kualifikimit për projekt propozimin “Parandalimi i dukurive negative dhe lëndëve narkotike” kandidatët të jenë të kualifikuar si mësimdhënës/e të lëndës: Sociologji, Edukatë Qytetare dhe Kimi, si vijon:

- Niveli master arsimor (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

3. Kriteret e kualifikimit për projekt propozimin “Zgjidhja e konflikteve në shkollë”; “Shëndeti mendor”; kandidatët të jenë të kualifikuar si mësimdhënës/e të lëndës: Sociologji, Psikologji, si vijon:

- Niveli master arsimor (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

4. Kriteret e kualifikimit për projekt propozimin “Trashëgimia kulturore dhe diversiteti kulturor” kandidatët të jenë të kualifikuar si mësimdhënës/e të lëndës: Histori - Edukatë Qytetare, si vijon:

- Niveli master arsimor (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

5. Kriteret e kualifikimit për projekt propozimin “Mbrojtja e mjedisit jetësor” dhe Biologji aplikative kandidatët të jenë të kualifikuar si mësimdhënës/e të lëndës: Biologji, si vijon:

- Niveli master arsimor (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

6. Kriteret e kualifikimit për projekt propozimin “Kodimi” dhe “Përdorimi dhe siguria në internet” kandidatët të jenë të kualifikuar si mësimdhënës/e të lëndës: TIK, si vijon:

- Niveli master arsimor (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

7. Kriteret e kualifikimit për projekt propozimin “Joga përmes edukatës muzikore”; “Joga përmes Psikologjisë” kandidatët të jenë të kualifikuar si mësimdhënës/e të lëndës: Edukatë muzikore, Psikologji si vijon:

- Niveli master (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

### III. Detyrat dhe përgjegjësitë e mësimdhënësit

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj/të punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri;
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi, barazi dhe pa dallime me bashkëpunëtorët të cilët punon;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Të mos kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç drejtorit të shkollës dhe DKA-së;
- Të mos e shfrytëzoi pozitën e punës për interesa private në dobi të ndonjë pale të tretë, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo miqësinë e tij.
- Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës. Përfshirë, ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhën me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik dhe juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton.
- Të mbaj orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.
- I punësuar i është i obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.
- I punësuar i nuk do të kryejë punë apo detyrë tjetër, me orar të plotë, nëse puna e tillë, bie ndesh me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga DKA-ja ose përfaqësuesit të saj.
- Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve, sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës;
- Punë dhe detyra të tjera shtesë të caktuara nga drejtori i shkollës dhe detyra të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të arsimit parauniversitar.

### IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit më 14.07.2023 deri më datën 28.07.2023;
- Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës;
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë **diplomat e nostrifikuara në MASHTI**;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit (numrin e protokollit), e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;

#### V. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit të mësimdhënësve për angazhim të përkohshëm për realizimin e kurrikulës me zgjedhje për vitin shkollor 2023/2024
- Kandidatët me kualifikime jo-përkatëse sipas ligjeve dhe UA të cekur në pikën II të këtij konkursi nuk do të merren në shqyrtim;
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen deri në 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Pikët e mbledhura në fazat vlerësuese renditin kandidatët me më shumë pikë që do të përzgjedhen në pozitat e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave publikohen në webfaqen e Komunës të Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/> (konkurset) dhe përmes e-mailit (bazuar në aplikacionin e kandidatit);
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web-faqen zyrtare të Komunës të Prishtinës;
- Në rast të ndonjë nevojë eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave të publikuara me rastin e shpalljes së rezultateve, e cila konsiderohet si listë pritëse;
- Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë do të jetë më datën 01.09.2023 si angazhime të përkohshme për vitin shkollor 2023/2024.
- Anëtarët e komuniteteve joshumicë dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

**Vërejtje:** Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.